



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 04.09.2025
Numër Protokolli: 6035/2025

A.nr.1421/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1421/2025, të datës 22.07.2025, të parashtruar nga ankuesja F.Z, nga Prishtina, kundër Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike/ZKM, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi, të nxjerrë akt administrativ lidhur me Kërkesën Nr.447 të datës 23.04.2025 të Akademisë së Drejtësisë.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, F.Z (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 21.07.2025 përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 22.07.2025, nën shenjë A.nr.1421/2025 dhe numër protokolli:4868/2025, kundër heshtjes administrative të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, në kërkesën Nr.447 të datës 23.04.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, ndërsa këta të fundit më datë 04.08.2025 kanë dërguar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 4868/2025 të datës 22.07.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën Nr.447 të datës 23.04.2025 me formularin e bashkangjitur; E-mailin e datës 15.04.2025 dërguar nga G.Z për Sh.L me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.07.2025, Përgjigjen në kërkesë të datës 04.08.2025; Përgjigjen e datës 15.03.2024 të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike për Këshillin me shkresat e bashkangjitur; Kërkesa e datës 01.09.2025 e Këshillit Drejtuar ankueses; Përgjigja e ankueses e datës 02.09.2025 drejtuar Këshillit; Akt Emërimit të datës 16.07.2025; Akt Emërimit të datës 26.11.2024.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e organit të punësimit të ankueses, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datës 23.04.2025 të parashtruar nga Akademia e Drejtësisë, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 26.11.2024 ka qenë e punësuar në Akademinë e Drejtësisë, në pozitën “Udhëheqëse e Divizionit të TI-së”, ndërsa sipas deklarimeve të ankueses përmes e-mailit të datës 02.09.2025 e njëjta deklaroi se nga data 01.08.2025 ka themeluar marrëdhënien e punës në kuadër të Zyrës Kombëtare të Auditimit, në pozitën “Specialist i Mbështetjes për Sisteme” sipas akt emërimit të datës 16.07.2025.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës të ofruara nga palët në procedurë, konstatoi faktin se Akademia e Drejtësisë përmes shkresës Nr.447 të datës 23.04.2025 i është drejtuar Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike me kërkesën që (SMAT) Sistemi për Menaxhimin e Aktiviteteve Trajnuese i Akademisë së Drejtësisë të përfshihet në grupin e sistemeve shtetërore të informacionit me rëndësi strategjike, ndërsa pozita të cilën ankuesja e ushtronte sipas aktit të emërimit “Udhëheqëse e Divizionit të Teknologjisë Informative”, të përfshihet në grupin e ekspertëve pasi që sistemi në fjalë është zhvilluar dhe administrohet në mënyrë të përhershme nga Udhëheqësit e Divizionit të IT dhe Zyrtarët të IT-së për sisteme kërkesë kjo të cilën Akademia e Drejtësisë e ka mbështetur në nenin 7 të Rregullores Nr.22/2024 për Ekspertët.

Në kërkesën për përgjigje në ankesë të dërguar nga Këshilli me datë 29.07.2025 për Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, këta të fundit me datë 04.08.2025 kanë kthyer përgjigje duke e konfirmuar pranimin e kërkesës së datës 23.04.2025

të Akademisë së Drejtësisë, mirëpo deklarojnë se për shkak të volumit të lëndëve-kërkesave ende nuk kanë mundur të vendosin, citoj përgjigjen e dhënë përmes emailit: “ *Në lidhje me kërkesën tuaj, gjeni të bashkëngjitura provat e kërkuara. Gjithashtu, ju njoftojmë se Komisioni për shkak të volumit të punës që ka pasur nuk ka arritur ende të shqyrtojë kërkesën e Akademisë së Drejtësisë. Deri më tani, Komisioni ka shqyrtuar kërkesat e pranuar nga themelimi i Komisionit e deri në fund të janarit dhe ka dërguar një raport me rekomandime për miratim në Qeveri, i cili ende nuk është miratuar.*”.

Fillimisht, Kolegji i Këshillit me qëllim të konstatimit të plotësimit të parakushteve ligjore të provueshmërisë së ankesës së ankueses, në mbështetje të nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji konstatoi faktin se ankuesja e ka legjitimitetin e palës aktive në procedurë pasi që në kërkesën e datës 23.04.2025 të Akademisë së Drejtësisë, parashihet që pozita të cilën e ka mbajtur ankuesja sipas Aktit të Emërimit, “*Udhëheqëse e Divizionit të TI-së*” të përfshihej në listën e ekspertëve, ndërsa ankesa e datës 22.07.2025 kundër heshtjes administrative të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike në kërkesën e datës 23.04.2025 të Akademisë së Drejtësisë, është parashtruar në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara nga nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, meqenëse organi i punësimit të palës ankuese, me datë 23.04.2025 ka parashtruar kërkesë te Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, atëherë Kolegji i Këshillit lidhur me obligimin e organit publik që të shqyrtoj kërkesën e palës dhe të nxjerr aktin administrativ, iu referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: “3. *Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar*”, nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: “1. *Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës*”, nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: “1. *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative*”, në këtë rast, në kuptim të nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*”, dhe për rrjedhojë konstatoi, se organi të cilit i është drejtuar kërkesa, në rrethanat e rastit konkret Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, është dashur të vendos brenda afatit prej 45 ditësh, apo të aplikohet neni 99 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mirëpo meqë kërkesa e palës ankuese nuk është shqyrtuar, atëherë është aplikuar heshtja administrative.

Sipas dispozitave ligjore në fuqi në rast se organi publik hesht ndaj kërkesës së palës, atëherë palës i lind e drejta që të parashtroj ankesë te organi kompetentë kundër heshtjes administrative duke u bazuar në dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “4. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ*”, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike ka heshtur ndaj kërkesës së Akademisë së Drejtësisë, ankesa e ankueses e datës 22.07.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në kuadrin ligjor të cekur si më lartë, lidhur me obligimin e organit përkatës për të vendosur lidhur me kërkesën e palës, e obligon Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, që të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës Nr.447 të datës 23.04.2025 të parashtruar nga Akademia e Drejtësisë, në atë mënyrë që gjatë shqyrtimit të kërkesës të shqyrtohen të gjitha pretendimet e palës ankuese dhe të vendoset për të gjitha pretendimet në fjalë në kuptim të nenit 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr1421/2025, datë 04/09/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.Z;
- Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike;
- Akademisë së Drejtësisë (Drejtorit Ekzekutiv), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.